




Prishtine, data: 28.05.2021

**KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE** - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 5516 dt. 30.12.2020 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **“Tropicana & Minervo” Sh.p.k** me pronar Lulzim Abazi, me nr.të biznesit 70028446, me adresë; Ferizaj, 13 Qershori p.n, merr këtë vendim :

### AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtresave për **“Tropicana & Minervo” Sh.p.k** me pronar Lulzim Abazi, me nr.të biznesit 70028446, me adresë; Ferizaj, 13 Qershori p.n, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .



Arsyetim

Ndaj **“Tropicana & Minervo” Sh.p.k** me pronar Lulzim Abazi, me nr.të biznesit 70028446, me adresë; Ferizaj, 13 Qershori p.n, KPMM ka lëshuar aktin administrativ nr. 5516 dt. 30.12.2020.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta me dt.11.01.2020 dhe me refuzimin që pala ka bërë për pranimin e shkresës personalisht është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

**Këshilla Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .



Ramiz Krasniqi

Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Rr. Armend Daci nr.1  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (38) 240 252  
Fax: +383 (38) 245 844  
E-mail: [ICMM@kosovo-mining.org](mailto:ICMM@kosovo-mining.org)  
Web: [www.kosovo-mining.org](http://www.kosovo-mining.org)

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosova



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale  
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale  
Independent Commission for Mines and Minerals



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE (KPMM)** në pajtim me nenin 79 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, duke vendosur ndaj ndërmarrjes "Tropicana & Minervo" Sh.p.k, me numër të biznesit 70028446 me adresë, Ferizaj 13 Qershori p.n, me pronar dhe përfaqësues të autorizuar Lulzim Abazi, lidhur me Lejen e Minimit B-045/KPMM nr.prot.1300/KPMM/07.04.2011, në procedurë administrative me datë 28.12.2020 nxjerr këtë:

### AKTVENDIM

- I. Ndaj: "Tropicana & Minervo" Sh.p.k, me numër të biznesit 70028446 me adresë Ferizaj 13 Qershori p.n.
- II. Për shkak të mos përmbajtjes të drejtave dhe detyrimeve në Licencën e Shfrytëzimit me Nr.709/KPMM/08 si dhe Lejes së Minimit B-045/KPMM nr.prot.1300/KPMM/2011 i shqiptohet gjoja administrative në shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro).
- III. Pala ka 15 ditë afat nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përcaktuar në pikën II të këtij dispozitivi në këtë xhirrollogari 1000430070005950.

### Arsyetim

Ndërmarrja e specializuar për shpim - minime "Tropicana & Minervo" Sh.p.k, me rastin e zhvillimit të aktivitetit minerar ka poseduar kontratë për shpim – minimet me ndërmarrjen Kastrioti O.P e cila ka poseduar Licencën e Shfrytëzimit me Nr.709/KPMM/08 në Carralevë Komuna e Shtimes, në baze të këtyre ndërmarrja me rastin e zhvillimit të aktivitetit minerarë dhe minues është e obliguar që ti përmbahet të drejtave dhe detyrimeve të licencës së shfrytëzimit si dhe lejes për minim në përputhje me Ligjin Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale si Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Për Miniera dhe Minerale si dhe çdo akti nënligjor të nxjerr sipas këtij ligji duke përfshi edhe Ligjin për Përdorim të Eksplozivëve.

Ndërmarrja e specializuar për shpim - minime "Tropicana & Minervo" Sh.p.k, duke zhvilluar aktivitetin minerar të minimit në licencën e ndërmarrjes "Kastrioti" me Nr.709/KPMM/08 me rastin e minimit me dt.08.04.2011 ka shkaktuar aksident me dëme materiale dhe jo materiale duke mos ju përmbajtur të drejtave dhe detyrimeve të licencës për shkak të mos marrjes së të gjitha masave të arsyeshme me qëllim të zbatimit të programit të shfrytëzimit të autorizuar me licencë dhe në përputhshmëri me programin e minierave e që është në kundërshtim me dispozitat materiale të nenit 34 parag.1.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale, ashtu që ndërmarrja gjatë veprimtarisë së përdorimit dhe asgjësimit të eksploziveve nuk ka garantuar sigurinë e personave si dhe nuk ka ndërmarr të gjitha masat e përcaktuara në ligjin për siguri në punë mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës duke dështuar të bëjë ekzekutimin e minimit pa pasoja në njerëz dhe sende, që është në kundërshtim me nenin 7.1, 7.1 dhe 28.1 të Ligjit Nr.03/L-005 për Përdorim Civil të Eksplozivëve, pra duke mos siguruar udhëheqjen dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së punëve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje dhe siguri gjatë punës, gjë që është edhe në kundërshtim me Udhëzimin

Rr. Armend Daci Nr.1  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (38) 240 252  
Fax: +383 (38) 245 844  
E-mail: [ICMM@kosovo-mining.org](mailto:ICMM@kosovo-mining.org)  
Web: [www.kosovo-mining.org](http://www.kosovo-mining.org)

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

Administrativ Nr.001/2011 nenin 4.1 për caktimin e personave përgjegjës në kompanitë të cilat janë licencuar në KPMM i cili ka qen në fuqi në ditën e aksidentit në minierë, e gjithë kjo përgjegjësi është vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore ne Ferizaj C.nr.534/12 dt.16.03.2017 i cili është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac.nr.2304/2017 të dt.06.10.2020.

Në rastin konkret është konstatuar se bartësi i lejes për minim nuk i ka përmbushur kërkesat materiale të Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale si dhe akteve nënligjore të nxjerr sipas këtij ligji duke përfshi edhe Ligjin Nr.03/L-005 për Përdorim Civil të Eksplozive për shkak të mos marrjes së të gjitha masave të arsyeshme me qëllim të zbatimit të programit të shfrytëzimit të autorizuar me licencë dhe leje duke dështuar të bëjë ekzekutimin e minimit pa pasoja në njerëz dhe sende gjë e cila është konstatuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore ne Ferizaj C.nr.534/12 dt.16.03.2017 dhe vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.2304/2017 të dt.06.10.2020.


Duke pasur parasysh Raportin nga Departamenti i Financave të datës 24.12.2020 me nr.prot.8851 si dhe arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky akt administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i KPMM-së.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit Shqyrtues për Ankesa të KPMM-së.

Aktvendimi i dërgohet:

- Arkivit të KPMM-së,
- Departamentit të Financave të KPMM-së,
- Palës.



Ramiz Krasnici  
Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale